



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:004975
Datë: 20.11.2024
Numri i dokumentit: 06483772

K.DH.SH.II.nr.996/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “BEL Plast” DOO, me numër të regjistrimit 10006114814, me seli në Użice, Serbi, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Alija Ajro, avokat nga Prizreni, kundër debitorit N.P.T “Euro Trade”, me numër unik identifikues 810877045, me seli në Prishtinë, Hajvali, “Afër Urës”, nr.18, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1319/23 i datës 01.03.2024, me datë 20.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit “BEL Plast” DOO, me numër të regjistrimit 10006114814, me seli në Użice, Serbi, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1319/23 i datës 01.03.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1319/23 të datës 01.03.2024, në dispozitivin e parë ka vendosur të Pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.T “Euro Trade”, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1004/2021, i lejuar me datë 26.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha anulohet, ndërsa procedura në këtë çështje përmbartimore përfundohet. Në dispozitivin e dytë ka vendosur që të obligohet kreditori që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej 416.00 Euro (katërqind e gjashtëmbëdhjetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori “BEL Plast” DOO, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me

propozim që gjykata ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit dhe të prishë aktvendimin e atakuar, ndërsa prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar.

Debitori përmes të autorizuarit, në përgjigje në ankesë ka theksuar se pretendimet e paraqitura nga ana e kreditorit janë të pabazuara, të paqëndrueshme e mbi të gjitha të pavërteta, me propozim që gjykata ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ankesën e kreditorit si dhe të vërtetojë aktvendimin KPPP.nr.1319/23 të datës 01.03.2024 të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “BEL Plast” DOO ka lëshuar urdhrin për përmbartim ndaj debitorit në bazë dokumentit të besueshëm - Faturës nr. (05) 0358-1 e datës 04.05.2018 dhe Faturës nr. (05) 0821-4 e datës 06.09.2018, me të cilin është detyruar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 11,906.29 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes së afatit për pagesë, si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumë prej 208.00 Euro, si dhe shpenzimet tjera procedurale sa do të jenë deri në përfundim të procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se faturat e prezantuara e kanë arritur parashkrimin, ashtu siç përcaktohet me nenin 355, par. 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kërkesa të cilat parashkruhen për tri (3) vite. Duke qenë se kërkesa e kreditorit është parashkruar sepse kanë kaluar mbi tre vite nga data e lëshimit të faturave, ndërsa propozimi për përmbartim është paraqitur me datë 26.10.2021, ashtu që ka skaduar afati kohor brenda së cilit sipas ligjit mund të kërkohej përmbartimi. Ka shtuar se faturat në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbartimore nuk janë pranuar nga ana e debitorit, duke qenë se nuk kanë as nënshkrim nga ana e debitorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet, si dhe të detyrohet kreditori që të paguajë shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 416.00 Euro dhe shpenzimet që do të krijohen deri në përfundim të kësaj procedure.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim, ka theksuar se pretendimet e debitorit se detyrimi i kërkuar është parashkruar nuk qëndron, për faktin se nga faturat detyrimi ishte 19,482.56 Euro, prej të cilës debitori ka përmbushur pjesërisht dhe siç mund të shihet edhe nga kartela e klientit për faturën nr. (05) 0358-1 detyrimi ka mbetur në shumë prej 8,264.63 Euro, ndërsa për faturën nr. (05) 0821-4 detyrimi ka mbetur në shumë prej

4,641.66 Euro, në total në shumë prej 12,906.29 Euro, ashtu që me datë 22.04.2021 lidhur me këtë detyrim ka paguar shumën prej 1,000.00 Euro. Ka shtuar se duke qenë se debitori ka bërë pagesa është ndërprerë parashkrimi i borxhit, ashtu siç përcaktohet me nenin 368 par.2 të LMD-së. Sa i përket pretendimit se faturat nuk janë pranuar nga debitori dhe nuk janë nënshkruar, nuk qëndron një pretendim i tillë për faktin se meqenëse debitori ka kryer pagesa të pjesërishme, i njëjti ka qenë i njoftuar për detyrimin e tij. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1319/23 të datës 01.03.2024, në dispozitivin e parë ka vendosur të Pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.T “Euro Trade”, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1004/2021, i lejuar me datë 26.10.2021, nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha, anulohet, ndërsa procedura në këtë çështje përmbartimore përfundohet. Në dispozitivin e dytë ka vendosur që të obligohet kreditori që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej 416.00 Euro (katërqind e gjashtëmbëdhjetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se duke i vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës gjeti se Fatura nr. (05) 0358-1, e datës 04.05.2018 është lëshuar dhe është bërë e arritshme për pagesë me datë 04.05.2018, ndërsa Fatura nr. (05) 0821-4, është lëshuar dhe është bërë e arritshme për pagesë me datë 06.09.2018, në anën tjetër propozimi për përmbartim në raport me këto fatura nga ana e kreditorit është paraqitur me datë 26.10.2021, dhe rrjedhimisht borxhi i cili buron nga faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata në shkallë të parë drejtë ka vendosur sa i përket parashkrimin të borxhit sipas Faturës nr. (05) 0358-1, e datës 04.05.2018 e lëshuar dhe e arritshme për pagesë me datë 04.05.2018, dhe Faturës nr. (05) 0821-4, e lëshuar dhe e arritshme për pagesë me datë 06.09.2018, pasi propozimi për përmbartim në raport me këto fatura nga ana e kreditorit është paraqitur me datë 26.10.2021, ashtu që sipas dispozitës së nenit 355 të Ligjit për

Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e faturave të cilat janë parashkruar sepse nga data e arritjes për pagesë/maturimit e deri në paraqitjen së propozimit për lejimin e përmbarimit kanë kaluar më shumë se 3 vite.

Tutje, Dhomat e Shkallës së Dytë sa i përket pretendimeve të kreditorit se parashkrimi është ndërprerë me arsyetimin se debitori ka pranuar borxhin përmes pagesës së pjesërishtme të faturës nr.0358-1 në shumë prej 1,000.00 Euro, i vlerëson si pretendime të paqëndrueshme pasi që dokumenti kartelë e klientit e datës 20.10.2021 i bashkangjitur nga kreditori në shkresat e lëndës, paraqet dokument të njëanshëm të lëshuar nga ana e kreditorit nga i cili nuk mund të vërtetohet nëse debitori vërtetë ka paguar një pjesë të borxhit që rrjedh nga fatura nr.0358-1 në shumë prej 1,000.00 Euro. Po ashtu, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se as nga dëshmia bankare në gjuhën serbe e bashkangjitur në shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet fakti se debitori ka realizuar pagesa tek kreditori në raport me faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim, kjo pasi që pagesa prej 980.00 Euro e cila evidentohet në këtë dëshmi, përshkruhet si “pagesë për mall”, prandaj edhe gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta marr si bazë për ndërprerje të afatit të parashkrimit, përderisa nuk ekzistojnë prova konkrete që dëshmojnë se debitori ka përmbushur borxhin që rrjedh nga faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.996/24, me datë 20.11.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha